

6.6 PËRDORIMI I KUJTESËS SË FRAGMENTEVE TË REGJISTRIMEVE NË PROCESIN E REDAKTIMIT

Të dhënat nga regjistrimet në kujtesën e fragmenteve mund t'i transferoni në regjistrimin, i cili ndodhet në redaktues. Gjithashtu në regjistrimet në kujtesën e fragmenteve edhe mund të kërkoni.

6.6.1 Kërkimi i tekstit

Në regjistrimin në kujtesën e fragmenteve mund të kërkoni tekstin e caktuar.

Procedura

1. Nga menuja e kontekstit përzgjidhni metodën **Gjej**.
Hapet dritarja **Kujtesa e fragmenteve**.
2. Në dritaren për shënimin e termit për kërkim shënoni tekstin që kërkoni dhe shtypni butonin **Në rregull**.
Teksti i kërkuar në regjistrimin në kujtesën e fragmenteve ngjyroset me ngjyrë të kaltër.

6.6.2 Kopjimi i tekstit

Nga regjistrimi në kujtesën e fragmenteve mund të kopjoni tekstin në nënfusha.

Procedura

3. Përzgjidhni tekstin, të cilin dëshironi ta kopjoni.
Teksti i përzgjedhur ngjyroset me ngjyrë blu.
4. Nga menuja e kontekstit përzgjidhni metodën **Kopjo tekstin**.
Teksti i përzgjedhur ruhet në kujtesën e fragmenteve të tekstit.

Mundësitë...

Tekstin mund ta kopjoni edhe duke shtypur tastet <Ctrl> + <C>.

6.6.3 Kopjimi i fushës

Nga regjistrimi në kujtesën e fragmenteve mund të kopjoni fushën dhe nënfushat përkatëse së bashku me përmbajtjen.

Procedura

1. Klikoni kudo në fushën, të cilën dëshironi të kopjoni.
2. Nga menuja e kontekstit përzgjidhni metodën **Kopjo fushën**.

Fusha e përzgjedhur dhe nënfushat përkatëse së bashku me përmbajtjen ngjyrosen me ngjyrë blu dhe ruhen në kujtesën e fragmenteve të fushave.

6.6.4 Kopjimi i nënfushës

Nga regjistrimi në kujtesën e fragmenteve mund të kopjoni nënfushën së bashku me përmbajtjen.

Procedura

1. Klikoni kudo në nënfushën të cilën dëshironi të kopjoni.
2. Nga menuja e kontekstit përzgjidhni metodën **Kopjo nënfushën**.

Nënfusha e përzgjedhur së bashku me përmbajtjen ngjyrosen me ngjyrë blu dhe ruhet në kujtesën e fragmenteve të nënfushave.

6.6.5 Kopjimi i përmbajtjes së nënfushës

Nga regjistrimi në kujtesën e fragmenteve mund të kopjoni gjithë përmbajtjen e një nënfushe.

Procedura

1. Klikoni kudo në nënfushën, përmbajtjen e së cilës dëshironi ta kopjoni.
2. Nga menuja e kontekstit përzgjidhni metodën **Kopjo përmbajtjen e nënfushës**.

Përmbajtja e nënfushës së përzgjedhur (pa shenjën e nënfushës) nënvizohet me ngjyrë blu dhe ruhet në kujtesën e fragmenteve të teksteve.